



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 292 Prot.

Tiranë, më datë 16.06.2026

**VENDIM**

**Nr. 204, datë 16.06.2026**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, i ndryshuar, neni 38, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.06.2026:

**VENDOSI**

1. Miratimin e ndryshimit të pjeshëm të projektit “Rikostruksion objekti dhe shtesë kati brenda volumit ekzistues” Brenda Kufirit Zonë e Mbrojtur e Qendrës Historike Berat, me aplikues Altus Atelier dhe zhvillues **Z. Robert Pushi**;
2. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas VKM Nr. 827, datë 28.12.2023, “Për deklarimin si pasuri kulturore e paluajtshme “Qendër Historike” të një zone në Qytetin-Muze të Beratit, përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj dhe miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e saj”, neni 13, pika 3, dhe të monitorohen nga DRTK Berat;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
5. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Endri HAXHIU**

